

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Nikollë Komani kryetari i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 24/2017 të datës 21.04.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **05.05.2017**, në prezencën e prokurores Shpresa Bakija, të akuzuarit A. B. dhe mbrojtëses së tij F. Zh. avokate në Gjakovë, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. B.** I biri i A. dhe S. e gjinisë H., i lindur më datë ... në Gjakovë, me banim, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, ka dyqan privat, i gjendjes së mesme ekonomike, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 10.10.2016, rreth orës 15:00 ka vuar në qarkullim paranë e falsifikuar bankënotën prej 100 euro, me numër serik S3042257876, në Bankën BKT në rr. "Nëna Terezë" në Gjakovë, duke ia dorëzuar arkëtares për deponim dhe pas ekzaminimit nga Agjensioni Kosovar për Forenzikë nr. AKF/2016-3524/2016-3165 të datës 15.12.2016 ka rezultuar se kjo bankënotë është e falsifikuar dhe është sekuestruar nga policia.

- **me çka ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52 par. 2, 73, 74, 75, 302 par. 2 dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-së, i shqipton:

D Ë N I M M E K U S H T

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale.

Konfiskohet bankënota e falsifikuar në apoen prej 100,00 € me numër serik S3042257876, si objekt i kryerjes së kësaj vepre penale.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **60,00 €** në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I. nr. 24/2017 të datës 21.04.2017 ka akuzuar A. B., për shkak të veprës penale falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezentë kanë qenë prokurorja Shpresa Bakija, i akuzuari A. B. dhe mbrojtësja e tij F. Zh. avokate në Gjakovë.

Prokurorja Shpresa Bakija ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes së arritur dhe kushteve të propozuara me marrëveshje, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të njëjtën marrëveshje ta aprovoi.

Mbrojtësja e të akuzuarit A. B. avokatja F. Zh. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes së arritur dhe kushteve të përcaktuara me marrëveshje, pasi i mbrojturi i saj pa ndikimin e askujt në mënyrë vullnetare e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e për të cilën pendohet, duke theksuar se nuk ka qenë i kujdesshëm kur e ka pranuar monedhën nga B. Th.

I akuzuarit A. B. ka theksuar se mbetet pranë marrëveshjes dhe deklarimeve të mbrojtëses së tij të dhëna gjatë këtij shqyrtimi.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurorisë, të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij, lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë, ka konstatuar se i akuzuarit A. B. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë sipas marrëveshjes, marrëveshja është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, i akuzuari nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në lidhjen e marrëveshjes, pranimin e fajësisë mbështet në faktet dhe provat që i janë bashkëngjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe është e bazuar në nenin 233 par. 21 të KPP-së dhe gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit prokurorja Shpresa Bakija ka deklaruar se mbetet pranë dënimit të propozuar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve deri në 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe ka propozuar që të konfiskohet bankënota e falsifikuar në apoen prej 100,00 € me numër serik S3042257876.

Mbrojtësja e të akuzuarit, avokatja F. Zh. ka theksuar se pasi i mbrojturi i saj është i moshës së re, për herë të parë paraqitet pranë organeve të ndjekjes, propozon që të njëjtit ti shqiptohet një dënim më i butë dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I akuzuari A. B. deklaron se mbetet pranë marrëveshjes dhe deklarimeve të mbrojtëses së tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marr parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrekte gjatë seancës, është i moshës së re, është hera e parë që paraqitet pranë organeve të ndjekjes, e të cilat rrethana kanë ndikuar që të aplikohen dispozitat e zbutjes së dënimit, e të akuzuarit A. B. ti shqiptohet dënimi i paraparë me marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e bankënotës së falsifikuar është marrë bazuar në nenin 302 par. 6 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 42/17 datë 05.05.2017

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.